



MUAJI PRILL

- 1. E enjte.** Oshënare Maria Egjiptiane. Dëshmorët Geronti dhe Vasilidhi. Ahazi i Drejtë.

Të enjten **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (leximi nga Isaia 11:10-12:2).

Të enjten **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 7:11-8:3; **Leximi II:** Fja. Urt. 10:1-22).

PASDARKA E MADHE

- 2. † E premte.** Oshënar Titi, mrekullibërës. Dëshmor Amfiani dhe Edhesi. Dëshmor i ri Panajoti.

III e Akathistit.

Të premten **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 13:2-13).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 8:4-21; **Leximi II:** Fja. Urt. 10:31-11:12).

Të premten **në mbrëmje**, HIMNI AKATHIST drejtuar Hyjlindëses (Qëndrimi III). Lexohet Pasdarka e vogël deri tek “Të meriton...”. Pas “Të meriton...” psalet kanoni i Himnit Akathist: “Ja gojën e çel...” dhe pas tij psalet: “Përlufteshës gjenerale...”. Më pas lexohet

Qëndrimi III i Përshëndetjeve të Hyjlindëses. Pas tyre, psalet sërish: “Përlufteshës gjenerale...”. Thuhet Trishenjti dhe Shkurtorja e ditës. Më pas thuhet: “Mëshiro, o Zot” (40 herë), “O Krisht Perëndi, që adhurohesh...” dhe pjesa e mbetur e Pasdarkës së vogël.

- 3. † E shtunë.** Nikita Omologjeti (Pohuesi). Oshënar Josif Himnografi. Oshënar Iliri në Mîrsion.

Të shtunën në mëngjes, **Mëngjesorja** e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 3-të të Kreshmës (Heb. 10:32-38).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 3-të të Kreshmës (Mk. 2:14-17).

- 4. † E DIEL. III E KRESHMËS (Falja e Kryqit).** Oshënar Gjergji në Male. Oshënarët Platoni dhe Zosimai.

Tingulli II. Ungjilli mëngjesor ngjallësor X.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzime të Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. II: “Shkoi hija e ligjit...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe Tani, e Triodit.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Kur zbritë te vdekja...”. “Lavdi...”, e Triodit: “O Zot, shpëtoje popullin tënd...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Gabrieli kur të tha...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës, por në vend të Hyjlindësore së stikologjisë (grupit) së parë, psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve të tingullit: “Të gjitha përmbi mendim...”. Si stikologji (grup) e tretë thuhet Ndenjësorja e Triodit dhe, për këtë arsye, nuk thuhet BEKIMTORET ngjallësore.

DËGJIMI, SHKALLESAT e PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit) dhe SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Moisiu i përmbihyjhëm...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor X.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX.

DËRGIMSORJA ngjallësore X dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta të Triodit, të cilat bëhen 4 (e para thuhet dy herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe (në Ting. IV [agjia]) dhe te Himni trishenjtor në fund të Dhoksologjisë kryhet shërbesa e Faljes së Kryqit.

SHËRBESA E FALJES SË KRYQIT TË NDERUAR

Në fund të Dhoksologjisë bëhet litania, e cila fillon para derës veriore të Shenjtërores. Litania kryhet në këtë mënyrë: Në fillim qëndrojnë djemtë që shërbejnë në Shenjtërore dhe mbajnë në duar qirinj të ndezur. Pas tyre vijnë ata që mbajnë gjashtëkrahëshet. Më pas qëndrojnë koret e psaltëve, të cilët psalin: “Shenjt Perëndi...”. Pas tyre ecin ata që mbajnë temjanicën dhe temjanisin.

Gjatë kohës që psalet: “Shenjt Perëndi...”, prifti, i veshur me stolinë e vet, temjanis Tryezën e shenjtë dhe Kryqin e nderuar, i cili ndodhet mbi një dhisk të stolisur me lule dhe me tre qirinj të ndezur. Më pas, prifti ngre dhiskun, e vendos mbi krye, kalon rreth e qark Tryezës së shenjtë, nga e djathta në të majtë, del jashtë Shenjtërores përmes derës veriore dhe, në formë litanie, shkon deri në fund të kishës dhe kthehet e vjen në mes të saj, ku ndodhet një tryezë e stolisur. Ai vjen tri herë rreth e qark tryezës dhe qëndron para saj, me fytyrë nga lindja.

Pas përfundimit të “Shenjt Perëndi...”, prifti thotë: “Urtësi. Drejt.”. Dhe e vendos dhiskun mbi tryezë, merr temjanicën dhe temjanis tryezën nga të katër anët dhe psal troparin: “O Zot, shpëtoje popullin tënd...”, të cilin e përsërisin edhe koret. Më pas, prifti i falet Kryqit të nderuar duke psalur himnin: “Kryqit tënd i falemi, o Zot...”, të cilin e përsërisin edhe koret. Më pas, koret

psalin troparet e vetëmelodishme, ndërsa besimtarët afrohen t'i falen Kryqit të nderuar dhe të marrin nga prifti një lule si bekim. Pasi besimtarët t'i jenë falur Kryqit dhe psaltët të kenë mbaruar së psaluri troparet e vetëmelodishme, psalet tropari ngjallësor: “Sot erdhi shpëtimi...” dhe fillon Liturgjia Hyjnore.

Shënim: *Kryqi i nderuar mbi dhiskun e stolisur, i cili ndodhet mbi tryezë, qëndron në mes të kishës deri të premtën e ardhshme, që t'i falen besimtarët. Të premtën, pas Orës IX dhe para se të nisë Liturgjia e Dhuratave të Parashenjtëruara, Kryqi nderohet për herë të fundit dhe më pas prifti e fut në Shenjtërore.*

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA: “Ejani t'i falemi... Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore, e Triodit dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit.

Në vend të Himnit trishenjtor, psalet himni: “Kryqit tënd i falemi...”.

APOSTULLI i së dielës së 3-të të Kreshmës (Heb. 4:14-5:6).

UNGJILLI i së dielës së 3-të të Kreshmës (Mk. 8:34-9:1).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Me ty gëzohet...”.

KUNGATORJA: “U shënuar mbi ne drita e fytyrës sate, o Zot. Alilua”.

Në vend të “Pamë dritën e vërtetë...”, psalet Përlëshorja e Kryqit: “O Zot, shpëtoje popullin tënd...”.

Të dielën **në mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA kataniktike.

5. E hënë. Dëshmor Klaudi, Diodori, Viktorini, Viktori, Papi, Serapioni, Niqifori. Dëshmor Thermi.

Të hënë **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 14:24-32).

Të hënë **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 8:21-9:7; **Leximi II:** Fja. Urt. 11:19-12:6).

PASDARKA E MADHE.

6. E martë. Eftihi i Kostandinopojës. Oshënar Grigor Sinaiti. Oshënar Grigor Athoniti. 120 dëshmorët në Persi.

Të martën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (leximi nga Isaia 25:1-9).

Të hënë **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 9:8-17; **Leximi II:** Fja. Urt. 12:8-22).

PASDARKA E MADHE.

7. † E mërkurë. Dëshmor Kaliopi. Dëshmorët Rufini dhe Akilina dhe 200 dëshmorët me ta. Oshënar Gjergji i Mitilinit.

Të mërkurën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 26:21-27:9).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 9:18-10:1; **Leximi II:** Fja. Urt. 12:23-13:9).

Të mërkurën ***në mbrëmje***, PASDARKA E MADHE.

8. E enjte. Apostujt Agavi, Rufi, Flegoni, Asingriti etj. nga të 70-t. Celestini i Romës. Amandi i Komos.

Të enjten ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 28:14-22).

Të enjten ***në mbrëmje***, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 10:32-11:9; **Leximi II:** Fja. Urt. 13:19-14:6).

PASDARKA E MADHE

9. † E premte. Dëshmor Efpsihi. Oshënar dëshmor Vadimi, Avdisi dhe 300 dëshmorët me ta në Persi.

IV e Akathistit

Të premten ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 29:13-23).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 12:1-7; **Leximi II:** Fja. Urt. 14:15-26).

Të premten ***në mbrëmje***, shërbesa e HIMNIT AKATHIST drejtuar Hyjlindëses (Qëndrimi IV). Lexohet Pasdarka e Vogël deri te “Të meriton...”. Pas “Të meriton...” psalet kanoni i Himnit Akathist: “Ja gojën e çel...” dhe pas tij psalet: “Përlufteshës gjenerale...”. Më pas lexohet Qëndrimi IV i Përshëndetjeve të Hyjlindëses, në fund të së cilës thuhet vetëm

Shtëpia I e Qëndrimit I: “Engjëlli kryetar...”. Pas tyre, psalet sërish: “Përlufteshës gjenerale...”. Thuhet Tri-shenjti dhe Shkurtorja e ditës. Më pas thuhet: “Mëshiro, o Zot” (40 herë), “O Krisht Perëndi, që adhurohesh...” dhe pjesa e mbetur e Pasdarkës së vogël.

- 10. † E shtunë.** Profetesha Olda. Dëshmorët Perikliu, Sofokliu, Demosteni, Miltiadhi dhe Epaminonda.

Të shtunën në mëngjes, **Mëngjesorja** e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 4-t të Kreshmës (Heb. 6:9-12).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 4-t të Kreshmës (Mk. 7:31-37).

- 11. † E DIEL. IV E KRESHMËS** (Shën Joani i Shkallës).

Hierodëshmor Antipa. Oshënaret Trifena dhe Matrona.

Tingulli III. Ungjilli mëngjesor ngjallësor XI.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. III: “Si të mos admirojmë lindjen...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por në të njëjtin tingull me Lavdinë e Triodit.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Le të dëfrejnë qielloret...”. “Lavdi...”, e Triodit: “Me lot të derdhur...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Të që linde për ne...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “**PERËNDI ËSHTË ZOTI...**”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës, por në vend të Hyjlindësorese së stikologjisë (grupit) së parë, psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve të tingullit: “Ty që ndërmjetove për shpëtimin...”.

BEKIMTORET ngjallësore, **DËGJIMI**, **SHKALLESAT** dhe **PARAVARGU** i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), **SHTËPIA** (e tingullit dhe e Triodit) dhe **SINAKSARI** (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe **UNGJILLI** mëngjesor ngjallësor XI.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet **PSALMI 50**. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore XI dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshebullta të Triodit, të cilat bëhen 4 (e para

thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbi-
bekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që u
ngjalle së vdekurish...”.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore, e Triodit dhe
e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit: “Përlufteshës...”.

Paravargu dhe Aliluari i tingullit.

APOSTULLI i së dielës së 4-t të Kreshmës (Heb.
6:13-20).

UNGJILLI i së dielës së 4-t të Kreshmës (Mk.
9:17-31).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Me ty gëzohet...”.

KUNGATORJA: “Lavdëroni Zotin...”.

“Pamë dritën...” dhe pjesa e fundit e Liturgjisë.

Të dielën **në mbremje**, kryhet MBRËMËSORJA
kataniktike.

12. E hënë. Omologjet Vasili i Paros. Oshënare Anthusa.
Oshënar Neofiti i Mbyllur. Akaki Kafsokaliviti.

Të hënë **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përdit-
shme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 37:33-38:6).

Të hënë **në mbremje**, MBRËMËSORJA e përdit-
shme e Kreshmës (Leximi I: Gjen. 13:12-18; Leximi II:
Fja. Urt. 14:27-15:4).

PASDARKA E MADHE.

13. E martë. Omologjet Martini i Romës. Dëshmor Elefteri, Zoili, Kindiliani. Dëshmore Dada.

Të martën ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 40:18-31).

Të martën ***në mbrëmje***, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 15:1-15; **Leximi II:** Fja. Urt. 15:7-19).

PASDARKA E MADHE

14. † E mërkurë. Apostujt Aristarku, Pudi dhe Trofimi, nga të 70-t. Dëshmor Ardalioni.

Të mërkurën ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 41:4-14).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 17:1-9; **Leximi II:** Fja. Urt. 15:20-16:9).

Të mërkurën ***në mbrëmje***, PASDARKA E MADHE.

15. E enjte. Dëshmor Kriski. Hierodëshmor Leonidhi i Athinës. Dëshmor Suki në Gjeorgji. Oshënar Paterni.

Të enjten ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 42:5-16).

Të enjten ***në mbrëmje***, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 18:20-33; **Leximi II:** Fja. Urt. 16:17-17:17).

PASDARKA E MADHE

- 16. † E premte.** Dëshmoret Agapi, Irini, dhe Hjonia. Dëshmoret Harisa, Niki etj. me to. Oshënar Amfilohu në Patmos.

Akathisti i plotë

Të premtën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 45:11-17).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (**Leximi I:** Gjen. 22:1-18; **Leximi II:** Fja. Urt. 17:17-18:5).

Të premtën **në mbrëmje**, shërbesa e plotë e HIMNIT AKATHIST drejtuar Hyjlindëses. Lexohet Pasdarka e Vogël deri te “Të meriton...”. Pas “Të meriton...” psalet tropari: “Si mori vesh porosinë e perëndishme...” (3 herë) dhe prifti lëçit Qëndrimin I të shtëpive. Në vazhdim psalet kanoni i Himnit Akathist: “Ja gojën e çel...”. Pas Këngës III, psalet Shkurtorja: “Përlufteshës gjenerale...” (1 herë) dhe prifti lëçit Qëndrimin II të shtëpive. Më pas psalet Kënga IV, V dhe VI e kanonit. Në vazhdim psalet Shkurtorja: “Përlufteshës gjenerale...” dhe prifti lëçit Qëndrimin III të shtëpive. Më pas psalet Kënga VII, VIII dhe IX e kanonit (në Këngën IX bëhet edhe temjanisja e kishës). Në vazhdim psalet Shkurtorja: “Përlufteshës gjenerale...” dhe prifti lëçit Qëndrimin IV të shtëpive, në fund të të cilave përsërit edhe një herë Shtëpinë I: “Engjëlli kryetar...”. Më pas psalet Shkurtorja: “Përlufteshës gjenerale...”. Thuhet Trishenjtë dhe Shkurtorja e ditës: “Përlufteshës gjenerale...”. Më pas thuhet: “Mëshiro, o Zot” (40 herë), “O Krisht Perëndi, që adhurohesh...” dhe pjesa e mbetur e Pasdarkës së Vogël.

17. † E shtunë. Hierodëshmor Simeoni në Persi. Dëshmor Adriani. Dëshmorët Abdela, Fusik dhe 1150 dëshmorët.

Të shtunën në mëngjes, **Mëngjesorja** e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i Hyjlindëses (21 nëntor - Heb. 9:1-7).

UNGJILLI i Hyjlindëses (8 shtator - Llk. 1:39-49, 56).

18. † E DIEL. V E KRESHMËS (Oshënare Maria Egjiptiane). Oshënar Joani. Eftthimi, ndriçues i Finlandës.

Tingulli IV. Ungjilli mëngjesor ngjallësor I.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhën 6 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e Triodit. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. IV: “Profeti David...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por në të njëjtin tingull me Lavdinë e Triodit.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Lëçitjen gazmore...”. “Lavdi...”, e Triodit: “Ti, o Nënë, pikërisht...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Ti që linde për ne...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore sipas radhës, por në vend të Hyjlindësore së stikologjisë (grupit) së parë, psalet Hyjlindësorja e Përlëshoreve të tingullit: “Misteri i fshehur...”.

BEKIMTORET ngjallësore, DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA (e tingullit dhe e Triodit), SHTËPIA (e tingullit dhe e Triodit), SINAKSARI (i ditës dhe i Triodit).

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor I.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Hapmi dyert e pendimit...”. “Tani...”, “Drejtomë në rrugët...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Unë i mjeri, duke kujtuar...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “Gjithë njerëzit...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore I dhe e Triodit.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta të Triodit, të cilat bëhen 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...”, e Triodit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e të dielave.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”.

Pas HYRJES, Përlëshorja ngjallësore, e Triodit dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA e Triodit: “Mbrojtje e paturpëruar...”.

Paravargu dhe Aliluari i tingullit.

APOSTULLI i së Dielës së 5-të të Kreshmës (Heb. 9:11-14).

UNGJILLI i së Dielës së 5-të të Kreshmës (Mk. 10:32-45).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Me ty gëzohet...”.

KUNGATORJA: “Lavdëroni Zotin...”.

“Pamë dritën...” dhe pjesa e fundit e Liturgjisë.

Të dielën **në mbrëmje**, kryhet MBRËMËSORJA kataniktike.

19. E hënë. Para Dafinave. Hierodëshmor Pafnuti i Jerusalemit. Dëshmor Filipa, Theodhori, Dioskori etj.

Të hënë **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 48:17-49:4).

Të hënë **në mbrëmje**, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (**Leximi I:** Gjen. 27:1-41; **Leximi II:** Fja. Urt. 19:16-25).

PASDARKA E MADHE.

20. E martë. Para Dafinave. Apostull Zakheu, nga të 70-t. Oshënar Theodor Trihini. Oshënarët Athanasi dhe Joasafi në Meteorë.

Të martën **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 49:6-10).

PRILL

Të martën ***në mbrëmje***, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi I: Gjen. 31:3-16; Leximi II: Fja. Urt. 21:3-21).

PASDARKA E MADHE.

21. † E mërkurë. Para Dafinave. Hierodëshmor Januari. Mbretëresha Aleksandra. Oshënar Anastasi i Antiokisë.

Të mërkurën ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 58:1-11).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (Leximi I: Gjen. 43:25-30, 45:1-16; Leximi II: Fja. Urt. 21:23-22:4).

Të mërkurën ***në mbrëmje***, PASDARKA E MADHE.

22. E enjte. Para Dafinave. Apostull Nathanaili. Oshënar Theodhor Sikeoti. Gai i Romës. Dëshmor Nearku. Oshënarët Teohari dhe Apostoli në Artë.

Të enjten ***në mëngjes***, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (leximi nga Isaia 65:8-16).

Të enjten ***në mbrëmje***, MBRËMËSORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi I: Gjen. 46:1-7; Leximi II: Fja. Urt. 23:15-24:5).

PASDARKA E MADHE.

23. † E premte. Para Dafinave. Dëshmori i Madh Gjergj Trofeprurësi. Dëshmorët Donati dhe Therini në Butrint.

Shënim: *Shërbesa e Dëshmorit të Madh Gjergj Trofepurësi do të psalet të Hënën e Ndrishme (3 maj).*

Të premten **në mëngjes**, MËNGJESORJA e përditshme e Kreshmës (Leximi nga Isaia 66:10-24).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara. Psalet shërbesa e Shën Lazarit, si në librin e Triodit.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, psalet stikologjia deri te vargu: “Nga thellësitë e shpirtit...” dhe nga ky e varg e në vazhdim thuhet tropari i vetëmelodishëm i Triodit (2 herë), tropari martirik (1 herë) dhe 5 Vargëzimet e vetëmelodishme të shën Lazarit (nga 1 herë secila). “Lavdi...”, e shën Lazarit. “Tani...”, tropari: “Ndërsa përfundojmë kreshmën e dobishme...”.

HYRJA, “O JISU KRISHT, dritë gazmore...” dhe LEXIMET E TRIODIT (**Leximi I:** Gjen. 49:33-50:26; **Leximi II:** Fja. Urt. 31:8-31).

“LE TË DREJTOHET LUTJA IME...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë së Dhuratave të Parashenjtëruara.

Të premten **në mbrëmje**, bëhet PASDARKA e Vogël.

24. † E shtunë. Ngjallja e Llazarit. Oshënare Elisabeta, mrekullibërëse. Dëshmor i ri Duka.

Shërbesa psalet si në librin e Triodit.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e shën Llazarit: “Vërtetove ngjalljen e përbashkët...” (3 herë).

NDENJËSORJA e parë: “Mëshirove Marinë...” (2 herë) dhe pas saj BEKIMTORET ngjallësore. Pas Bekimtoreve thuhet LITANIA E VOGËL: “Përsëri dhe përsëri...” dhe NDENJËSORJA II: “O burim i së mirës...” (2 herë). Menjëherë pas Ndenjësores lexohet: “NE QË PAMË NGJALLJEN...” dhe PSALMI 50.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e shën Lazarit. SINAKSARI i ditës dhe i Triodit.

ZBRITËSORET: “U hodh nëpër detin...”.

Pas Këngës VIII, në vend të: “Më të nderuarën...” psalet Kënga IX e kanoneve të Triodit, me vargun: “Lavdi më Ty, o Perëndia ynë, lavdi më Ty!” dhe Zbritësorja IX.

“I shenjtë është Zoti...” (“Lartësoni Zotin, Perëndinë...”, nuk thuhet).

DËRGIMSORET e Triodit.

LAVDËRIMET: psalen 8 Vargëzimet e vetëmelodishme të shën Lazarit, sipas radhës. “Lavdi...”, e shën Lazarit. “Tani...”, “E përmbibekuar je, o Hyjlindëse...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe tropari: “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e përditshme. Refreni i Andifonit II është: “Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”, ndërsa refreni i Andifonit III është Përlëshorja e shën Lazarit: “Vërtetove ngjalljen e përbashkët...”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona..., që u ngjalle së vdekurish...”.

PAS HYRJES: Përlëshorja e shën Lazarit: “Vërtetove ngjalljen e përbashkët...” dhe Shkurtorja e shën Lazarit: “Jisui Perëndi, gëzimi i të gjithëve...”.

Në vend të Himnit trishenjtor: “SHENJTI PERËNDI...”, psalet himni: “Sa u pagëzuat më Krishtin...”.

Paravargu dhe Aliluari i së kremtes.

APOSTULLI i së shtunës së Lllazarit (Heb. 12:28-13:8).

UNGJILLI i së shtunës së Lllazarit (Jn. 11:1-45).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Joan Gojartit, si zakonisht.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet irmosi i Këngës IX të kanonit: “Le ta lavdërojmë Zonjën Mari...”.

KUNGATORJA: “Nga goja e foshnjave...”.

Në vend të troparit: “PAMË DRITËN E VËRTETË...”, psalet Përlëshorja e shën Lllazarit: “Vërtetove ngjalljen e përbashkët...”.

Përlëshimi: “Ai që u ngjall së vdekurish, Krishti, Perëndia ynë...”.

Shënime:

1. *Nga sot dhe deri të dielën e Etërve të Shenjtë, nuk përdoret më Lutësorja.*

2. *Nga sot deri të dielën e Thomait, në Mëngjesore, në vend të “Më të nderuarën...” psalet Kënga IX e kanonit të çdo dite, ndërsa në Liturgji, te “Veçan të Tërëshenjten...”, psalet: “Të meriton...”.*

3. *Nga sot deri të dielën e Pentikostisë, në Liturgji, nuk psalet tropari: “Pamë dritën e vërtetë...”, por Përlëshorja e së kremtes.*

4. *Gjithashtu, nga sot deri të dielën e Thomait nuk kryhet përshpirtje me grurë, por, në fund të Liturgjisë, mund të kryhet Trisai e thjeshtë pa grurë, ku kujtohen emrat e të fjeturve.*

25. † E DIEL. E DAFINAVE (E PALMAVE). Hyrja e Zotit tonë Jisu Krisht në Jerusalem. Apostull dhe Ungjillor Marku.

Shërbesa e Dhëndrit

Shënim: Shërbesa psalet si në librin e Triodit, ndërsa shërbesa e Ungjillor Markut do të psalet të Martën e Ndrithshme (4 maj).

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...”, thuhet 5 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6, duke thënë 2 herë të parën. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

Hyryja me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Gjen. 49:1-2, 8-12; **Leximi II:** Sof. 3:14-19; **Leximi III:** Zak. 9:9-15).

PASVARGJET e së kremtes (te Triodi). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes (te Triodi).

PËRLËSHORET: “Vërtetove ngjalljen e përbashkët...”. “Lavdi...”, po ajo. “Tani...”, “U varrosëm me pagëzimin tok me Ty...”.

PËRLËSHIMI: “Ai që pranoi të rrijë mbi një pulisht për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.

Shënim: Gjatë Javës së Madhe do të kryhen tri Liturgji të Parashenjtëruara.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET e Triodit sipas radhës. SHKALLE-SAT: “Që prej rinisë...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes.

“Ne që pamë Ngjalljen...” nuk lexohet. Pas Ungjillit lexohet menjëherë psalmi 50. Dhe troparet pas Psalmi 50, si në librin e Triodit. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës dhe i së kremtes.

ZBRITËSORET: “Ja u pa Det’ i Kuq...”.

MADHËSHTIMET e Hyjlindëses: Në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e kanonit të së kremtes.

DËRGIMSORJA: “I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë” (3 herë). Në vazhdim, prifti lexon uratën e Bekimit të dafinave.

LAVDËRIMET: 4 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes (nga një herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “Gjashtë ditë para Pashkës...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes: “U varrosëm me pagëzimin...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA: “*I bekuar është ai që ujen në emrin e Zotit. Perëndi është Zoti dhe u shfaq ndër ne. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që ndenje mbi një kafshë të përulur, ne që të psalim: Aliluia*”.

Pas HYRJES, Përlëshoret: “Vërtetove ngjalljen e përbashkët...” dhe: “U varrosëm me pagëzimin...”, si

dhe SHKURTORJA e së kremtes: “Në qiellin si Mbret mbi fron...”.

Himni trishenjtor. Paravargu dhe Aliluari i së kremtes.

APOSTULLI i së dielës së Dafinave (Filip. 4:4-9).

UNGJILLI i së dielës së Dafinave (Jn. 12:1-18).

Dhe vazhdon si zakonisht Liturgjia e Shën Joan Gojartit.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...” thuhet irmosi i Këngës IX të kanonit të së kremtes.

KUNGATORJA: “I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit. Aliluia”.

Në vend të troparit: “Pamë dritën e vërtetë...”, psalet Përlëshorja: “Ngjalljen e përbashkët...” dhe Përlëshimi si në Mbrëmësore.

Besimtarët afrohen të marrin nga priftërinjtë naforë dhe degë dafinash.

Të dielën në **mbrëmje** kryhet MËNGJESORJA e së Hënës së Madhe (në *Librin e Javës së Madhe*).

26. † E HËNË. E MADHE. Kujtimi i Josifit të lumur, të fortbukur dhe të fortmirë të Dhiatës së Vjetër, si dhe të fikut që u mallkua dhe u tha prej Zotit. Hierodëshmor Vasili i Amasisë. Oshënarët Glafira dhe Justa.

Shërbesa e Dhëndrit

Të Hënën e Madhe në **mëngjes** kryhet MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (në *Librin e Javës së Madhe*).

Të Hënën e Madhe në **mbrëmje** kryhet MËNGJESORJA e së Martës së Madhe (në *Librin e Javës së Madhe*).

27. † E MARTË. E MADHE. Kujtimi i shëmbëlltyrës së Zotit për 10 virgjëreshat. Hierodëshmor Simeoni i Jerusalemit, i afërm i Krishtit. Oshënar Evlogj Mikpritësi.

Shërbesa e Dhëndrit

Të Martën e Madhe **në mëngjes** kryhet MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (*në Librin e Javës së Madhe*).

Të Martën e Madhe në **mbrëmje** kryhet MËNGJESORJA e së Mërkurës së Madhe (*në Librin e Javës së Madhe*).

28. † E MËRKURË. E MADHE. Kujtimi i gruas mëkatore që leu Zotin me miro. 9 dëshmorët në Kizikë. Oshënar Memnoni, mrekuilibërës.

Të Mërkurën e Madhe **në mëngjes** kryhet MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Dhuratave të Parashenjtëruara (*në Librin e Javës së Madhe*).

Të Mërkurën e Madhe në **mbrëmje** kryhet Shërbesa e Efqelisë (Vajit të Bekuar [*në Librin e Uratores së Vogël*]).

29. † E ENJTE. E MADHE. Kujtimi i Lajtores së Shenjtë, Darkës Mistike, Lutjes së përmbinatyrshme të Zotit në Gjethsemani dhe tradhtisë së Judës ndaj Zotit. Apostujt Jasoni dhe Sosipatri, nga të 70-t. Oshënar Vasili i Ostrogut.

Shënim: *Sot, gjatë Proskomidhisë, nxirret edhe një Qengj i dytë, i cili, pasi shenjtërohet në Liturgjinë Hyjnore dhe pasi thahet me kujdes, ruhet për nevojat e grigjës shpirtërore gjatë gjithë vitit.*

Të Enjten e Madhe në **mëngjes** kryhet MËNGJESORJA e së Enjtes së Madhe (në *Librin e Javës së Madhe*).

MBRËMËSORJA dhe LITURGJIA e Shën Vasilit të Madh (në *Librin e Javës së Madhe*).

Të Enjten e Madhe në **mbrëmje** kryhet MËNGJESORJA e së Premtes së Madhe (Shërbesa e pësimeve të shenjta dhe të kulluara të Zotit tonë Jisu Krisht [në *Librin e Javës së Madhe*]).

30. E PREMTE. E MADHE. Kujtimi i Pësimeve të shenjta shpëtimtare dhe të tmerrshme të Zotit, Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht. Apostull Jakovi, vëllai i Ungjillorit Joan. Oshënar Donati i Evisë.

Të Premten e Madhe në **mëngjes** kryhet shërbesa e ORËVE TË MËDHA dhe MBRËMËSORJA e së Shtunës së Madhe (Shërbesa e Zbritjes së Trupit nga Kryqi [në *Librin e Javës së Madhe*]).

Të Premten e Madhe në **mbrëmje** kryhet MËNGJESORJA e së Shtunës së Madhe – Vajtimet e Përmbivarrshme (në disa vende, sipas një tradite më të vjetër, kryhet në orët e para të mëngjesit të së shtunës [në *Librin e Javës së Madhe*]).